

V E N D I M
Nr.501, datë 18.7.2003

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.230, DATË 22.5.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR STRUKTURËN DHE ORGANIKËN ANALITIKE TË
ADMINISTRATËS DOGANORE”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë“, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet vendimit nr.230, datë 22.5.1999 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Në Departamentin Operativ-Hetimor, në varësi të shefit të Departamentit Operativ-Hetimor krijohet njësi e kontrollit pas zhdoganimit (Posteriori).

b) Numri i përgjithshëm i punonjësve të njësisë së kontrollit pas zhdoganimit (Posteriori) të jetë 10 (dhjetë) vetë.

c) Numri i komandantëve të grupit të Drejtorisë së Antikontrabandës nga "20 (njëzet) vetë" të bëhet “15 (pesëmbëdhjetë) vetë”.

ç) Numri i doganierëve të antikontrabandës nga “80 (tetëdhjetë) vetë” të bëhet “75 (shtatëdhjetë e pesë) vetë”.

2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano